

Divizionet e Shërbimeve të DMH për Fëmijët, të Rinjtë dhe Familjet (CYF)

SHËRBIMET	PËRSHKRIMI
Menaxhimi i Rasteve (CM)	Menaxhimi i Çështjeve të Fëmijëve, të Rinjve dhe Familjeve është një shërbim shtetëror që siguron shërbime të individualizuara për të rinjtë me nevojat më të mëdha të shëndetit mendor dhe familjet e tyre. Shërbimet përfshijnë vlerësim të plotë të nevojave; hartim dhe monitorim të planit të shërbimeve; informacione dhe referime; asistencë për akses në shërbime të tjera; koordinim të kujdesit dhe mbështetje dhe avokati intensive.
Shërbimet Mbështetëse Fleksibël	Shërbimet Mbështetëse Fleksibël përfshijnë shërbime të ndryshme mbështetëse komunitare, klinike të individualizuara, terapeutike dhe nga persona me të njëjtat përvoja, për të rinj me shqetësime serioze emocionale dhe familjet e tyre. Shërbimet janë programuar për të mbështetur mirëqenien dhe pavarësinë e të rinjve dhe familjeve të tyre; për të ndërtuar kohezion në familje; për jetëgjatësi më të madhe të marrëdhënieve të rëndësishme në jetën e të rinjve; për të parandaluar nevojën për shërbime më intensive.
Shërbimet Ditore të Terapisë	Shërbimet Ditore të Terapisë janë shërbime shumë të strukturuar komunitare klinike dhe terapeutike që mbështetin të rinj nevojat e shëndetit mendor të cilëve interferojnë me aftësinë e tyre për të marrë pjesë me sukses në aktivitetet e familjes, shkollës dhe komunitetit. Shërbimet janë të disponueshme në ambiente dhe situata të ndryshme, dhe mbështetin dhe promovojnë angazhimin në aktivitete pro-sociale; zhvillimin e aftësive të zgjidhjes së problemeve, komunikuese dhe ndërpersonale; dhe ndërtimin e marrëdhënieve me njerëz me të njëjtat përvoja.
Shërbimet Komunitare Intensive	Shërbimet Komunitare Intensive ofrojnë shërbime në shtëpi dhe trajtime jashtë shtëpisë për të rinj dhe të rritur të rinj përmes tri modeleve të shërbimit: Kujdes Intensiv Terapeutik në Shtëpi (IHBTC), Kujdes Terapeutik në Grup (TGC) dhe Kujdes Terapeutik për të Rritur të Rinj (YATC). IHBTC siguron ekipe që ofrojnë shërbime në shtëpi për të mbështetur të rinjtë dhe familjet në stabilizimin dhe vazhdimësinë e trajtimit ndërkohë që i riu është në shtëpi. TGC dhe YATC sigurojnë trajtime jo në shtëpi, objektivi i të cilave është të mundësojnë kthimin në shtëpi. Të tria shërbimet sigurojnë trajtime klinike intensive dhe mbështetje për të ndihmuar në ndërtimin, fuqizimin dhe vazhdimësinë e lidhjeve me familjen, shtëpinë dhe komunitetin, në mënyrë që i riu dhe familja të mund të jetojnë së bashku me sukses. Për të rriturit e rinj që nuk mund të jetojnë me familjet e tyre, shërbimet YATC mund të sigurojnë një urë mbështetëse për të jetuar të pavarur duke ruajtur lidhjen me familjen dhe mbështetjen e saj.
Shërbimet e Trajtimit Intensiv	Shërbimet e Trajtimit Intensiv janë trajtimet klinike më intensive në Komunuelth për të rinj me shqetësime emocionale serioze / sëmundje mendore. Shërbimet përfshijnë Shërbime Kujdesi të Vazhduar për Adoleshentë të Shtruar, Programe Trajtimi Intensiv në Rezidencë për Adoleshentë, (IRTP), dhe Trajtim Klinik Intensiv në Rezidencë (CIRT) për fëmijë.

Mbështetje Terapeutike në Shkollë dhe Komunitet	Mbështetja Terapeutike në Shkollë dhe Komunitet siguron mbështetje nga persona me të njëjtat përvoja për të rinj në moshë tranzicioni dhe prindërit e fëmijëve me nevoja të shëndetit mendor; informacione dhe referime; mbështetje, arsim dhe përkrahje individuale; trajnim; navigim në sistem; ndihmë për grupe komunitare në të gjithë shtetin që ofrojnë mbështetjeje për shëndetin mendor të fëmijëve. Konsultimet dhe trajnimet janë gjithashtu në dispozicion të shkollave, agjencive komunitare dhe organizatave të tjera që kujdesen për shëndetin mendor të fëmijës dhe familjes, reagimin ndaj traumave dhe parandalimin. Prindërit trajnohen për të dhënë këto shërbime.
Të Rinjtë në Moshë Tranzicioni dhe Të Rriturit e Rinj	Shërbimet për Të Rinjtë në Moshë Tranzicioni dhe Të Rriturit e Rinj (TAYA) janë ura mes Divizioneve të Shërbimeve të Departamentit të Shëndetit Mendor për Fëmijët, të Rinjtë dhe Familjet. DMH vë në kontakt të rinjtë dhe të rriturit e rinj me shërbimet dhe mbështetjet e duhura që plotësojnë nevojat e tyre klinike dhe zhvillimore. DMH ofron shërbime dhe mbështetje specifike të hartuara për të plotësuar nevojat unike të të rinjve dhe të të rriturve të rinj të moshave 16-22 vjeç.
Informacione dhe Referime	DMH u përgjigjet kërkesave për informacione dhe asistencë me referimet nga individë, organizata dhe agjenci të tjera në Komunuelth që kërkojnë burime, udhëheqje dhe informacione mbi kushtet e shëndeti mendor të fëmijës dhe shërbimet.
Konsultim dhe Edukim	DMH ofron konsultime klinike me ekspertë, edukim dhe trajnim për një gamë të gjerë individësh, agjencish dhe organizatash. Fushat me prioritet të veçantë janë Shëndeti Mendor në Foshnjëri dhe Fëmijëri të Hershme dhe Fëmijët që Shfrytëzohen Seksualisht për Përfitime (CSEC).
Programi i Massachusetts për Akses në Psikiatrinë e Fëmijës (MCPAP) dhe MCPAP për Nënat	MCPAP ndihmon mjekët pediatër dhe të tjerë ofrues Kujdesi Parësor Pediatric (PCPs) të menaxhojnë probleme të moderuara të shëndetit mendor dhe përdorimit të substancave të fëmijët për të cilët kujdesen, dhe lidh familjet me shërbime shëndetësore psikiatrike dhe të specialiteteve të tjera të sjelljes për fëmijë me nevoja shëndetësore më të komplikuara të sjelljes shëndetësore. MCPAP për Nënat fokusohet në sigurimin e edukimit dhe këshillimit për ofruesit e kujdesit obstetrik, ofruesit e kujdesit parësor dhe mjekëve psikiatër që trajtojnë gra që vuajnë nga trauma pas lindjes dhe probleme të tjera shëndetësore, gjatë shtatzënisë dhe deri një vit pas lindjes. Të dyja programet janë në dispozicion të çdo ofruesi kujdesi në Massachusetts që kërkon mbështetje të tillë.
Qendra e Njohurive mbi Shëndetin e Sjelljes së Fëmijëve	Qendra e Njohurive shërben si qendër informacionesh për sistemin e shëndetit të sjelljes së fëmijëve nëpërmjet Simpoziumit Vjetor, website-it, seminareve dhe webinareve. Aktivitetet e qendrës mundësojnë dhe lehtësojnë lidhjen mes gamës së gjerë së kërkuesve në fushën e shëndetit të sjelljes së fëmijëve, hartuesve të programeve, ofruesve të kujdesit, mjekëve, avokatëve të konsumatorëve në Massachusetts dhe udhëheqësve në inovacion dhe praktikat më të mira.